



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 39, datë 23.07.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN E KONFISKUAR: “HOTEL 1
DHE 6 KATE, ME 2 KAT NËNTOKË, NË FUNKSION TË ZYRAVE TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS” ME VENDODHJE NË RRUGËN
“QAMIL GURANJAKU”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 27, gërmës (ç) të pikës 1 të 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 27 të Ligjit Nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, Vendimit akteve nënligjore në zbatim të saj, gërmës (c) të pikës 3 të Nenit 19 të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 6, datë 18.06.2025 të Komisionit të Objekteve të Konfiskuara, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin e konfiskuar: “Hotel 1 dhe 6 kate, me 2 kat nëntokë, në funksion të zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, me vendndodhje në rrugën “Qamil Guranjaku”, Bashkia Tiranë, me zhvillues Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarës vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;

4. Pas miratimit të lejes përkatëse, Agjencia e Zhvillimit të Territorit do të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.
5. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me Çertifikatën e Përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
6. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT


BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28/07 2025